

**PASTËR.**

**PROGRAMI**  
*për* **KOMUNËN**  
*e* **KUMANOVËS**

2021 – 2025



Alleanca për Shqiptarët  
& Alternativa

# **PASTËR.**

PROGRAMI për KOMUNËN e KUMANOVËS  
2021-2025

I KOALICIONIT  
**ALEANCA PËR SHQIPTARËT & ALTERNATIVA**

Shtator, 2021

Qeverisja e koalicionit Aleanca për Shqiptarët dhe Alternativa do të bazohet në parimet e qeverisjes së mirë duke nisur nga transparencja si dhe llogaridhënia. Qeverisja jonë do të bazohet në pesë shtyllat e programit tonë të përgjithshëm komunal 2021-2025:

- 1. Pastër: qeverisja e mirë dhe transparencja**
- 2. Komuna demokracisë pjesëmarrëse**
- 3. Administrata komunale efikase, moderne dhe në shërbim të qytetarëve**
- 4. Komuna e mirëqenies për të gjithë**
- 5. Komuna me zhvillim të qëndrueshëm lokal**
- 6. Komuna me rend dhe plan në çdo cep**

Masat e propozuara në këtë program nuk janë medoemos përgjegjësi direkte e autoriteteve lokale, por ato pasqyrojnë në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe koherente politikën që Koalicioni Aleanca për Shqiptarët dhe Alternativa synon të zbatojë në nivelin lokal. Ne besojmë se decentralizimi dhe fuqizimi i mëtejshëm i komunave tona varet në masë të madhe nga politikën dhe infrastruktura rregullative në nivelin qendror. Andaj do të vazhdojmë të ndjekim dhe të shtojmë prioritetet horizontale të programit tonë qendror "Shtet për të Gjithë" 2020-2024.

Këto prioritetë kanë të bëjnë me parakushtet themelore për një vetëqeverisje lokale efikase, efiçente dhe në shërbim të interesit dhe nevojave të qytetarëve në nivelin lokal, me synim të ofrimit të një shërbimi cilësor dhe të barabartë për të gjithë. Ato përfshijnë ndër tjera zbatimin e një modeli të mirëfilltë decentralizimi, zhvillim të barabartë rajonal dhe ndaljen e politikave diskriminuese të zbatuara nga niveli qendror, si dhe avancimin e kornizës ligjore me qëllim të forcimit të rritjes së subsidiaritetit dhe kapacitetit të komunave për të përmbushur misionin e tyre. Me plotësimin e këtyre parakushteve do të mundësohet vetëqeverisje lokale efikase dhe efiçente, në shërbim të qytetarëve.

# 1 Pastër: qeverisja e mirë dhe transparencja

Korrupsioni i lartë i politikanëve të partive që tradicionalisht kanë udhëhequr me vendin në dy dekadat e kaluara, korrupsion ky që është endemik dhe i përhapur në çdo sferë të jetës shoqërore, ka dëmton në masë të madhe besimin e qytetarëve ndaj politikës dhe çështjeve publike. Duke qenë se fuqizimi i nivelit lokal është pjesë e ADN-në së koalicionit tonë, dëshmuar në qeverisjet tona të deritanishme komunale, ne konsiderojmë si urgjent rikthimin e besimit të qytetarëve në politikën, në veçanti në komunë, si niveli më i afërt me brengat e përditshme të qytetarëve.

Mbrojtja e interesit të përgjithshëm, ndershmëria dhe transparencja në ushtrimin e funksionit publik janë lajtmotivi apo elementet thelbësore të partisë sonë. Komuna duhet të jetë pararojë kundër cenimeve që i kanosen demokracisë. Ne angazhohemi për transparencën e plotë të vendimeve politike, përmes të gjitha kanaleve të komunikimit për t'u mundësuar qytetarëve dhe shoqërisë civile që të kërkojnë veprime konkrete dhe llogaridhënie nga përfaqësuesit politikë të tyre.

Koalicioni Aleanca për Shqiptarët dhe Alternativa angazhohet për qeverisje me duar të pastra: transparencë, llogaridhënie, qeverisje të mirë dhe me zero tolerancë ndaj korrupsionit. Ne zotohemi për:

- **Transparencë të plotë për shpenzimet operative komunale (open data).**
- **Zyrë për auditim të brendshëm që i raporton komitetit për auditim.**
- **Kod të etikës për përfaqësuesit politikë në nivel komunal.**
- **Rekrutim transparent dhe objektiv të personelit komunal dhe të strukturave nën përgjegjësinë e komunës dhe rritja e transparencës së arsyeve të pushimit nga puna.**
- **Shkarkimi i menjëhershëm i zyrtarëve komunalë ndaj të cilëve merret vendim gjyqësor i formës së prerë në çështje penale.**
- **Zhvillimi i interaktivitetit të web faqeve të komunës, përfshirë transmetimin e drejtpërdrejtë të mbledhjeve të këshillit komunal.**

- Zbatimi i përpiktë i ligjit për përdorimin e gjuhëve dhe garantimi i të drejtave gjuhësore të qytetarëve.
- Përfaqësimi i drejtë dhe adekuat i komuniteteve dhe përfaqësim i ekuilibruar gjinor.

## 2 Komuna e demokracisë pjesëmarrëse

Koalicioni Aleanca për Shqiptarët dhe Alternativa angazhohet për pjesëmarrje të qytetarëve në vendimmarrje, mbështetje të shoqërisë civile lokale, forcim të solidaritetit, efikasitet dhe cilësi të shërbimeve komunale, si dhe promovim të projekteve inovative dhe të qëndrueshme për të bërë jetën komunale më dinamike. Komuna do të jetë e hapur për të gjithë pavarësisht përkatësisë etnike, fetare apo partiake.

### Decentralizimi dhe bashkëpunimi ndërkomunal

Koalicioni Aleanca për Shqiptarët dhe Alternativa do të angazhohet për forcimin e strukturës institucionale lokale, me qëllim të rritjes së efikasitetit dhe të cilësisë së shërbimeve për qytetarët. Dy akset kryesore dhe komplementare që do të ndjekim drejt këtij qëllimi janë: forcimi i rajoneve planore dhe rritja e bashkëpunimit mes tyre dhe komunës, dhe avancimi i bashkëpunimit ndërkomunal.

### Demokracia pjesëmarrëse

Ne do të inkurajojmë demokracinë pjesëmarrëse për t'u mundësuar qytetarëve që të rrisim interesimin e tyre për çështjet publike, do të nxisim pjesëmarrjen në jetën e komunës dhe do të rrisim ndikimin pozitiv të qytetarëve mbi përfaqësuesit e tyre të zgjedhur. Në këtë rrafsh, propozimet tona janë:

- Krijimi i një platforme informative që u mundëson qytetarëve të përfshihen më drejtpërdrejtë në zhvillimin e projekteve komunale dhe në procese të caktuara vendimmarrëse.
- Publikimi dhe thjeshtëzimi i buxhetit komunal në një formë të qartë dhe vizuale.
- Publikimi në web faqen e komunës të regjistrit i të gjitha organizatave (OJQ,

shoqata, klube sportive, etj.) që marrin subvencione komunale.

- Sinjalizimi i qartë informativ pranë punishteve, ku sqarohet qëllimi i projektit, kohëzgjatja, kostoja, autoritetet përgjegjëse, përfshirë edhe ilustrime projektuese dhe të dhënat kadastrale.
- Krijimi i një aplikacioni komunal për informim të drejtpërdrejtë të qytetarëve dhe ndërveprim në kohë reale me autoritetet komunale.
- Sistematizimi në secilën komunë të korrnizës ligjore për pjesëmarrjen qytetare.
- Transparencë e plotë e dokumenteve të projekteve të reja infrastrukturore, të cilat do të jenë të qasshme në një sallë të dedikuar për këtë qëllim në komunë.
- Mekanizma të demokracisë pjesëmarrëse lokale, siç janë iniciativat qytetare, petitionet, pyetjet për kryetarin e komunës dhe këshilltarët si dhe referendumi lokal.
- Krijimi i një buxheti pjesëmarrës;
- Sistematizimi i bordeve / këshillave konsultative (planifikim hapësinor, zhvillimi rural, arsim, aftësim profesional, fëmijët, të rinjtë, të moshuarit, personat me aftësi të kufizuara, etj.).

## 3

# Administrata komunale efikase, moderne dhe në shërbim të qytetarëve

## Shërbime komunale cilësore për të gjithë

- Me qëllim të rritjes së efikasitetit dhe efektshmërisë së shërbimeve komunale, ne angazhohemi gjithashtu për promovimin dhe zbatimin e modelit të qeverisjes ndër-komunale, krahas forcimit të rajoneve planore dhe rritjes së bashkëpunimit mes tyre dhe komunës. Koalicioni Aleanca për Shqiptarët dhe Alternativa propozon:
- Organizimi më i mirë dhe i hapur i pritjes së qytetarëve në godinën komunale.
- Instalimi i sporteveve elektronike që ofrojnë shërbime të përhershme, 24 orë në ditë, 7 ditë në javë.
- Qasje më e mirë në infrastrukturën komunale për personat më lëvizshmëri të zvogëluar.
- Promovimi i një shërbimi cilësor dhe me kosto më të ulët për qytetarët në sektorët e shpërndarjes së ujit, planifikimit hapësinor apo trajtimit të mbeturinave.
- Hapja e zyrës së veçantë për diasporën.

## Transformimi digjital dhe e-qeverisja

- Qeverisja elektronike ose e-qeverisja, përveç se ndihmon në efikasitet, ajo i ulë edhe kostot komunale. Ne do të angazhohemi për zbatimin e masave në

vijim:

- Digjitalizimi i infrastrukturës administrative komunale.
- Një platformë unike online që do të përfshijë edhe ndërmarrjet publike përkatëse, sidomos ujësjellësin dhe do të shoqërohet me një aplikacion komunal për informim të drejtpërdrejtë të qytetarëve dhe ndërveprim në kohë reale.
- Zbatimi i një politike të të dhënave të hapura (open data) dhe qasje e lirë në të dhënat me karakter të interesit publik, për transparencë totale të përdorimit të mjeteve komunale, rekrutimeve në administratë dhe një menaxhim më të mirë të komunës.
- Fond special për investime në teknologji, për mirëmbajtjen e infrastrukturës digjitale dhe modernizimin e saj.
- Forcimi i rrjetit të ndriçimit rrugor dhe ndriçimi inteligjent (ndriçim bazuar në detektimin e lëvizjeve).
- Mbështetja e modaliteteve të reja të transportit publik (car pooling dhe car sharing) përmes teknologjive dhe platformave bashkëpunuese digjitale.
- Zhvillimi i infrastrukturës inteligjente për menaxhimin e trafikut.
- Krijimi i qendrave për inovacion (“Innovation Hubs”), inkubatorë dhe akceleratorë, qendra për arsim joformal dhe biblioteka digjitale publike.
- Krijimi i një web faqe dhe një aplikacioni komunal apo ndërkomunal që promovojnë monumentet dhe hapësirat me interes turistik dhe ofertën hoteliere, përfshirë bujtinat rurale private.

## Siguri në çdo cep të komunës

Ne do të zbatojmë politikë të zero tolerancës ndaj veprime delikuede dhe degraduese të hapësirës publike. Do të zbatojmë përgjigje shumëdimensionale përmes edukimit, informimit, parandalimit, politikave të afërsisë me qytetarët dhe planifikimit të duhur të hapësirës publike.

- Në bashkëpunim me autoritetet qendrore, organizimi i kornizës ligjore për krijimin e një shërbimi komunal parandalues (“paqeruajtës”) përgjegjës për parandalimin e veprimeve delikuede dhe degraduese të ambientit apo

infrastrukturës komunale, përfshirë sigurinë përreth shkollave tona dhe objekteve komunale.

- Dënime administrative për të gjitha veprimet delikuede dhe degraduese të hapësirës publike.
- Instalimi i një sistemi të kamerave inteligjente.
- Zbatimi i një plani të ndriçimit të qëndrueshëm, i cili mundëson vënien në pah të trashëgimisë komunale dhe kontribuon në rritjen e ndjenjës së sigurisë.
- Forcimi i shërbimeve zjarrfikëse.
- Zgjidhja e problemit të qenve dhe maceve endacake, duke u dhënë një subvencion qytetarëve që duan të sterilizojnë dhe çipojnë qentë dhe macet e tyre dhe duke krijuar strehimore rajonale për qentë endacakë. Ne gjithashtu do të krijojmë një shërbim veterinar komunal, përgjegjës për çipimin e qenëve endacakë, sterilizimin e tyre dhe krijim e një databaze, në bashkëpunim me shoqatat për mbrojtjen e kafshëve.

## 4 Komuna e mirëqenies për të gjithë

Vizioni jonë për vetëqeverisjen lokale është rritja e investimeve në kapitalin tonë mjedisor dhe atë njerëzor, duke u përqendruar në këto prioritete: mjedisi, arsimi, shëndetësia, mbrojtja sociale, kultura dhe sporti.

### Mbrojtja e natyrës dhe e mjedisit jetësor

- Përmirësimi i cilësisë së ajrit, duke ngritur koordinimin me autoriteteve qendrore dhe duke krijuar një regjistër lokal për matjen e cilësisë së ajrit, favorizuar makinat elektrike apo me gaz për nevojat e shërbimeve komunale, rritur numrin e shtigjeve për biçikleta, subvencionimin e biçikletave, mbjelljen e druve dhe shpërndarjen e druve zbukurues dhe pemor falas për çdo qytetar të interesuar.
- Vendosja në Lagjen e Barakave dhe në Lagjen Dardania të mburojave akustike për parandalimin e ndotjes akustike dhe zhurmës nga autostrada, si dhe rregullimi i sipërfaqes përreth autostradës dhe nën ura për te varrezat e qytetit. Ky projekt do të realizohet gjatë vitit të parë të mandatit.
- Mbështetja e ekonomisë qarkore në menaxhimin e mbeturinave nga një perspektivë ndërkomunale.
- Rritja e frekuencës së pastrimit të rrugëve dhe të numrit të pastruesve.
- Monitorim i përhershëm i pastërtisë publike, përmes një raporti vjetor që do të paraqitet në këshillin komunal.
- Vendosja e kontejnerëve inteligjentë.
- Grumbullimi nga ndërmarrjet komunale të gjësendeve të mëdha si mobile të vjetra dhe pajisje shtëpiake, të destinuara për riciklim dhe ridestininim përmes një platforme bashkëpunuese (B2B dhe B2C).
- Zbatimi i klasifikimit selektiv të mbeturinave në hapësirën publike.
- Inkurajimi i nismave lokale që synojnë luftimin e shpërdorimit të ushqimit të pa shitur, duke i ndërlidhur këta aktorë ekonomikë me shoqatat që u ndihmojnë njerëzve në vështirësi.
- Ruajtja, mirëmbajtja dhe rritja e hapësirave të gjelbra, zonave natyrore si dhe mbrojtja e biodiversitetit.
- Revitalizimi i tërësishëm i parkut të qytetit i cili është lënë në harresë totale të qëllimshme nga organet komunale vetëm për faktin se ky park gjendet në pjesën me shumicë shqiptare të qytetit. Ky park aktualisht është në gjendje të mjerueshme, tërësisht i parregulluar dhe skajshmërisht i shkatërruar. Me Planin e ri gjeneral duhet bërë riplanifikimi i ri i shtratit të lumit në pjesën e stadionit Bashkimi që shtrati i lumit të kalojë nën bulevardin Oktomvriska Revolucija. Gjithashtu, shiritat e gjelbërimit të cilat janë në Planin aktual, me Planin e ri gjeneral të hiqen, gjegjësisht të bëhen njëjtë sikurse prej Stacionit të autobusëve deri në Qendrën tregtare TUSH.
- Gjithashtu do të angazhohemi gjatë vitit të parë të qeverisjes sonë për rregullimin e kanalit kullues në lagjen Hekurudha.
- Ngrirja e menjëhershme e zgjerimit urban anarkik si në zonat urbane ashtu edhe në ato rurale me qëllim të ruajtjes së zonave të gjelbra, të pyllëzuara dhe atyre bujqësore.
- Rritja e eficiencës energjetike të ndërtesave publike, me synim të uljes së konsumit të karburanteve të ngrohjes për 40% dhe e konsumit të energjisë elektrike për 15% deri në vitin 2025 për të gjitha ndërtesat në pronësi apo menaxhim të komunës.
- Instalimi i rezervuareve për mbledhjen e ujit të shiut në ndërtesat në pronësi apo menaxhim të komunës.
- Subvencione shtesë krahas atyre qeveritare, për të inkurajuar kursimin e energjisë.
- Krijimi i një zyre komunale të energjisë e cila centralizon të gjithë informatat e dobishme rreth përdorimit efikas të energjisë dhe subvencionet qeveritare dhe komunale i cili gjithashtu këshillon dhe përkrah qytetarët në aplikimet e tyre për subvencione.
- Krijimi i një sektori komunal për mbrojtjen e mjedisit.

## Shëndetësia

Komuna do të promovojë shëndetin në të gjitha politikat lokale me qëllim të ofrimit të shërbimeve cilësore në gjithë komunën tonë. Ne propozojmë:

- Bashkimin e shtëpive të shëndetit me spitalet e përgjithshme të qytetit.
- Rritje të investimeve në renovimin e infrastrukturës së stërvjetruar së spitalit të qytetit.
- Rinovimi i ambulantsë në Lagjen e Trimave dhe vendosja në shërbim të qytetarëve.
- Hapje të qendrave për mjekësi urgjente.

## Arsimi

Prioriteti ynë kryesor do të jetë modernizimi dhe përmirësimi i procesit arsimor. Kujdesi për mësimdhënie dhe kushte cilësore në shkolla do të jenë preokupim ynë i përditshëm, duke u fokusuar në prioritetet në vijim:

- Rritja e numrit të vendeve në çerdhe drejt objektivit të një normë mbulimi (numri i vendeve në çerdhe në raport me numrin e fëmijëve) prej 33%.
- Inkurajimi i krijimit të strukturave plotësuese, siç janë çerdhet me bazë në komunitet, çerdhet private dhe forma tjera siç janë kujdesi ditor.
- Përmirësimi i infrastrukturës shkollore dhe planifikimi i hapësirave të reja shkollore, në veçanti projektet në vijim.
  - Do të zgjidhim pronësinë e shkollës fillore Bajram Shabani (Kumanovë) dhe kjo shkollë do të pajiset me inventar të ri dhe pajisje dhe mjete të reja për kabinete. Do të largohet centrali elektrik nga oborri i shkollës. Pajisja në vazdhimësi e kabineteve me pajisje dhe mjete.
  - Do të zgjidhim pronësinë e shkollës fillore Naim Frashëri (Kumanovë) dhe kjo shkollë do të pajiset me inventar të ri dhe do të bëhet ndërrimi i tërësishëm i dysHEMEVE të klasave. Do të sigurohet edhe ndërtimi i disa klasave të reja për mësim deri në klasën e pestë tek lagja e Barakave në kuadër të SH.F. Naim Frashëri.
  - Vendosja e kabineteve dhe laboreve nëpër shkollat e Kumanovës

(Lagja e Trimave), Çerkezit dhe Rramanlisë.

- Te shkolla fillore Kirili dhe Metodi (Rramanli) do të ndërrohet sallë sportive dhe do të rregullohet fusha sportive në oborrin e shkollës.
  - Shkolla fillore Jeronim De Rada (Çerkez) do të pajiset me inventar të ri.
  - Te shkolla fillore Kongresi i Manastirit (Llopat) do të ndërtohet sallë sportive, shkolla do të pajiset me inventar të ri dhe do të përmirësohen kushtet higjieno-sanitare.
  - Sa u përket përcelimeve me mësim në gjuhën shqipe në SHFK Toli Zordumis (Kumanovë), do të bëhet shpërndarja e barabartë e nxënësve nëpër klasa dhe emërimi i drejtorit të shkollës me rotacion.
  - Do të bëhet rikonstruimi i tërësishëm i objektit shkollor të shkollës fillore të Sopotit e cila do të pajiset me inventar të ri.
  - Sa i përket shkollës së mesme (gjimnaziit) Sami Frashëri, do të sigurojmë gjatë vitit të parë të qeverisjes sonë anulimin e vendimit të këshillit komunal për dislokimin e gjimnazit në hapësirat e ish kazermës dhe ndërtimin e objektit të ri për gjimnazin në pjesën qendrore të qytetit.
  - Sa i përket shkollës së mesme teknike Nace Bugjoni, do të sigurojmë gjatë vitit të parë të qeverisjes sonë kthimin në objektet ekzistuese në rrugën Bajram Shabani, ose ndërtimin e një objekti të posaçëm.
  - Shkolla e mesme ekonomike Pero Nakov, gjatë vitit të parë të qeverisjes sonë, do të pavarësohet nga shkolla amë Pero Nakov. Shkolla do të pajiset me inventar të ri, do të ndërtohen kabinete për drejtimet profesionale të cilat do të pajisen me mjete adekuate.
- Gjimnaz për teknologji dhe shkenca digjitale në Kumanovë.
  - Klube për inovacion në shkollat fillore dhe të mesme.
  - Hapja e qendrave për aftësim profesional dhe krijimi i qendrave rajonale për të mbështetur arsimin joformal.
  - Krijimi i një komiteti konsultativ për arsim fillor dhe të mesëm në nivel komunal, ku do të marrin pjesë përfaqësues të sektorit privat, qeverisjes lokale dhe shkollave fillore dhe të mesme në nivel të komunës.
  - Fondi i përkrahjes së shkollave për organizimin e aktiviteteve jashtë



shkollore.

- Programe vjetore komunale për trajnim të arsimtarëve.
- Krijimi i së paku një ndërmarrje në çdo shkollë të mesme profesionale, e cila ofron apo prodhon shërbime.
- Hapja e klasave për qëndrim tërëditor për nxënësit deri në klasën e katërt.
- Vizita vjetore mjekësore në të gjitha nivelet e arsimit komunal.
- Angazhimi i një orto pedagogu përgjegjës për zbulim të vështirësive dhe çrregullimeve në të mësuarit tek fëmijët, në parashkollore dhe në shkollë fillore.
- Rritja e inkluzivitetit për nxënësit me nevoja të veçanta.
- Bursa për fëmijët e talentuar apo nga familjet me nevojë.
- Shpërndarja në çerdhe dhe shkolla fillore e një shujte ditore falas.
- Inkurajimi i krijimit të shoqatave të prindërve dhe përfshirja e tyre në projektet arsimore komunale si dhe në jetën shoqërore të lagjes dhe fshatit.

## Mbrojtje sociale dhe politikat inkluzive

Do të planifikojmë politika gjithëpërfshirëse për kategoritë të veçanta sociale, në veçanti:

- Promovimi i integritit socio-profesional të personave me aftësi të kufizuara dhe ndërmarrja e masave për të promovuar autonominë e tyre.
- Qasje e lehtësuar në objektet në pronësi dhe menaxhim të komunës për njerëzit me lëvizshmëri të reduktuar.
- Zbatimi i projekteve gjithëpërfshirëse në shkollat dhe çerdhet komunale, për të promovuar përfshirjen në shoqëri të fëmijëve me aftësi të kufizuara ose me vështirësi në të mësuar.
- Qendër për autizëm.
- Zhvillimi i shërbimeve për të moshuarit, përfshirë ndërtimi i një shtëpie për të moshuarit dhe i një qendre ditore për të moshuarit.

- Inkurajimi i krijimit të restoranteve sociale dhe të shitoreve sociale, në bashkëpunim me aktorët ekonomik (shitore, tregje, etj) dhe shoqërinë civile.
- Investimi në ndërtimin e kapaciteteve të reja për strehimin e personave në rrezik shoqëror, përfshirë viktimat e dhunës seksuale, dhunës në baza gjinore dhe viktimave të trafikimit me qenie njerëzore.

## Kultura

Banorët e komunës do të krenohen me pasurinë kulturore, trashëgiminë kulturore dhe rendësinë historike të pasurisë sonë arkitektonike dhe kulturore. Ne propozojmë:

- Decentralizimin e shtëpisë së kulturës dhe muzeut të qytetit.
- Themelimin e teatrit shqiptar në Kumanovë.
- Ndihma financiare dhe subvencionimi i shoqatave kulturore artistike shqiptare.
- Bashkëfinancimin e festivaleve të ndryshme shqiptare të organizuara në komunën e Kumanovës.
- Stimulimin e artistëve të pavarur në komunën e Kumanovës.
- Ndihma financiare për manifestimet e shoqatave të shkrimtarëve shqiptarë në komunën e Kumanovës.
- Riaktivizimin ose ndërtimin e kinemasë në Kumanovë.
- Themelimi i muzeve rajonale ndërkomunale për ruajtjen e vlerave tradicionale, që do të jenë nën kompetencat e pushtetit lokal.
- Qendra rinore të resurseve (QRR) në çdo komunë.
- Stimulimi i aktiviteteve lidhur me artin dhe edukimin artistik në shkolla, për zhvillimin e punës krijuese dhe mendimit kritik.
- Shpërndarje e kuponëve kulturor për të rinjtë dhe studentët, për të siguruar hyrje falas në ngjarjet kulturore komunale.
- Rritja dhe diversifikimi i ofertës artistike në forma të reja, duke përkrahur për shembull artin urban përmes thirrjeve për projekte për të zbuluar muret e ndërtesave të braktisura apo infrastrukturën komunale (mure,

tunele, ura, etj.).

- Krijimi i hapësirave të akomodimit për artistët dhe i hapësirave bashkëpunuese kulturore publike ose në partneritet me sektorin privat.
- Vënia në pah dhe valorizimi i trashëgimisë komunale, duke organizuar shtigje kulturore, në bashkëpunim me shoqatat kulturore.

## Sporti

---

Synimi ynë është që komuna të gëzojë pozicion të favorshëm kombëtar në sferën e sportit. Do të inkurajojmë një jete aktive dhe të shëndoshë me të cilën në veçanti do të përfitojë të rinjtë. Ne propozojmë:

- Infrastrukturë sportive cilësore për të gjithë nxënësit.
- Ndërtimi i një salle sportive për shkollën fillore të Rramanlisë si dhe rregullimi i fushës sportive në oborrin e shkollë.
- Sallat sportive do të përkrahin aktivitetet e klubeve sportive, aktivitetet rekreative dhe ato garuese.
- Rregullimi i stadiumit ndihmës të KF Bashkimi 1947.
- Rregullimi i tërësishëm i stadiumit të qytetit.
- Shkollë të mesme për sport.
- Zhvillimi i infrastrukturës së sportit në rrugë (fusha të vogla sportive, zona të fitnesit, etj.
- Njërtimi në Çerkez të një stadioni për futboll dhe një këndi për fëmij.
- Ndërtim i një qendre moderne rekreativo sportive në rrugën Veselin Vueviq të Lagjes së Trimave.
- Ndarja e parcelës për stadionin e futbollit në fshatin Llopat, qysh në vitin e parë të qeverisjes sonë. Gjithashtu do të bëhet ndërtimi i një këndi të lojërave për fëmijë.
- Projektimi dhe ndërtimi i komplekseve rekreativo-sportive për Lagjen e Barakave, Skenderbeu dhe Dardania (Kumanovë).

- Ndërtimi i qendrës rekreative sportive të ish Shtëpia Feriale afër parkut të qytetit, në parim sikur ajo të salla e sporteve.
- Rritja e subvencioneve për klubet dhe shoqatat sportive. Do të kërkojmë me ngulm që në fillim të mandatit tonë dhe do të sigurojmë dotacione nga ana e pushteti qendror për klubet sportive shqiptare që janë në harresë edhe pse shumë aktiv dhe me suksese konstante, Kërkimi me ngulm dhe sigurimi i dotacioneve nga ana e pushteti qendror për klubet sportive që janë në harresë edhe pse shumë aktiv dhe me suksese konstante siç janë shkollat e futbollit për të rinjtë, klubet e shahut, ciklizmit, basketbollit etj.
- Bursa për sportistët e rinj të suksesshëm dhe mbështetje financiare për sportistët e nivelit të lartë.
- Stimulimi dhe mbështja e garave sportive ndërshkollore.
- Ndërtimi i shtigjeve për biçikleta dhe këmbësorë në të gjithë territorin e komunës.

# 5 Komuna me zhvillim të qëndrueshëm lokal

## Zhvillimi i ekonomisë lokale dhe i punësimit

Ne jemi të përkushtuar për fuqizimin dhe zhvillimin e NVM-ve, përmirësimin e kushteve dhe rrethanave për krijimin e ndërmarrjeve të reja dhe mbështetjen e bizneseve lokale. Në bashkëpunim me ekspertët, sektorin e biznesit si dhe organizata të ndryshme do të krijojmë kushte edhe për tërheqjen e investimeve të huaja, përfshirë nga diaspora, për të siguruar një zhvillim të qëndrueshëm lokal si dhe vende të reja pune.

Komuna jonë do të jetë një vend i zhvilluar ekonomikisht si dhe krijimin e vendeve të reja të punës. Ajo do të inkurajojë, udhëzojë dhe orientojë qytetarët në kërkimin e një vendi pune, por gjithashtu do të zhvillojë bashkëpunim me organizata të ndryshme qendrore siç është Agjencia e Shërbimit të Punësimit, odat ekonomike dhe institucionet e arsimit profesional, në mënyrë që të inkurajojnë qytetarët që të orientohen drejt vendeve të punës deficitare ose aftësisimit profesional. Në këtë rrafsh, propozimet tona janë:

- Miratimi i një plani zhvillimor komunal, që synon zhvillim të qëndrueshëm mjedisor dhe të barabartë shoqëror.
- Programe trajnimi dhe mbështetje të NVM-ve për e-tregti.
- Krijimi i zyrës së ekonomisë lokale për të mbështetur individualisht NVM-të dhe sipërmarrësit përmes ofrimit të shërbimeve specifike.
- Projekte për “fshatra inteligjente”, si ndihmesë për fermerët për t’i promovuar produktet lokale, turizmin rural, si dhe aktivitetet kulturore rurale.
- Promovimi dhe valorizimi i produkteve lokale, duke mbështetur prodhuesit lokalë në prokurimet komunale, shujtat shkollore e të çerdheve dhe duke u krijuar kushte shtesë për të rritur cilësinë e produkteve të tyre me synim të

rritjes së kapaciteteve eksportuese.

- Promovimi i zinxhirëve të shkurtra ushqimore, duke mbështetur produktet lokale në tregje dhe shitore, si dhe platformat digjitale për porositje të produkteve lokale.
- Nxitja e bashkëpunimit midis institucioneve akademike për zhvillim të “research and development” në nivel të kompanive.
- Punë praktike për studentët në institucionet komunale.
- Nxitja dhe ruajtja e artizanateve.

## Turizimi

- Rinovimi i atraksioneve turistike dhe i trashëgimisë arkitektonike komunale me interes për turistët.
- Ndërtimi i parkut të Lagjes Dardania me standarde moderne dhe rregullimi i një shëtitore rreth lumit. Ky projekt do të realizohet gjatë vitit të parë të qeverisjes sonë.
- Në periferinë e Kumanovës gjithashtu do të investohet për të rregulluar rrugët dhe ndërtuar shtigje për shetitje, sport, biçiklizëm dhe rekreacion në të gjitha vendet me mundësi ndërtimi.
- Krijimi i një web faqe dhe një aplikacioni komunal që listojnë dhe promovojnë monumentet dhe hapësirat me interes turistik brenda territorit të komunës, turizmin rural, si dhe ofertën hoteliere, përfshirë bujtinat rurale private.
- Zhvillimi i një rrjeti shtigjesh dhe shëtitjesh të gjelbra, malore dhe rurale.

# 6 Komuna me rend dhe plan në çdo cep

## Planifikimi urban dhe rural

Do të përqendrohemi në modernizimin dhe adresimin e pabarazisë në sektorët e mobilitetit, rrugëve, infrastrukturës komunale, planifikimit hapësinor, tokës ndërtimore, urbanizimit dhe energjisë. Prioritete të veçanta do të kenë rritja e konektivitetit lokal dhe atij rajonal, si dhe avancimi dhe modernizimi i infrastrukturës lokale, veçanërisht sa i përket ujit të pijshëm, kanalizimeve dhe trajtimit të ujërave të zeza. Komuna do jetë vend me infrastrukturë më të përparuar duke adaptuar planin zhvillimor me nevojat investuese në infrastrukturë.

Ne promovojmë arritjen e objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm të vendosura nga instancat ndërkombëtare dhe evropiane që synojnë uljen drastike të konsumit energjetik, ruajtjen dhe mirëmbajtjen e hapësirave të gjelbra, zonave natyrore dhe mbrojtjen e biodiversitetit.

Ne angazhohemi gjithashtu për promovimin e trashëgimisë lokale, natyrore dhe arkitekturale, duke riorganizuar hapësirën publike në mënyrë estetike dhe të qëndrueshme.

Planifikimi hapësinor në nivelin komunal duhet të synojë ngrirjen e zgjerimit urban anarkik, në dëm të hapësirave të gjelbra, pyjeve dhe tokës bujqësore. Dendësimi i territorit do të favorizojë zhvillimin e formave të banimit më të përshtatura me sfidat mjedisore dhe nevojat dhe mundësitë financiare të çifteve të reja, që janë viktimat e para të rritjes së çmimeve të patundshmërisë.

Për të arritur këto objektiva, propozojmë:

- Ujë të pijshëm, rrugë cilësore dhe kanalizime për të gjitha vendbanimet, në veçanti projektet në vazhdim.
  - Lagja e Trimave dhe Lagja e Barakave (Kumanovë): instalimi i gypave të

ri të ujësjellsit dhe kanalizimit.

- Lagja Skënderbeu (Kumanovë): rregullimi i rrjetit të kanalizimit dhe i pjesës së mbetur të ujësjellsit.
  - Çerkez: rregullimi i kanalit kullues në lagjen Hekurudha.
  - Rramanli: rregullim i kanalizimit dhe zgjidhja e problemit për kyçje në sistem me komunat fqinje, si dhe zgjidhja e problemit për kyçje në sistemin qendror nga stacioni i filtrimit me gyp qendror te ri per zgjidhje afatgjate.
  - Çerkez, Rramanli dhe Llopat: dhe ndërtimi i ujësjellsit dhe kanalizimit dhe ndriçimi cilësor me energji rinovuese.
- Gazifikimi i qytetit të Kumanovës.
  - Hapja në Lagjen e Trimave (Kumanovë) e punkteve pagesore për të gjitha shërbimet komunale: ujësjellsi, pastrim-gjelbërimi, etj.
  - Miratimi i planit të ri urbanistik me qëllim të zbatimit të normave urbanistike evropiane, ngrirjes së zgjerimit urban anarkik, dhe ruajtjes dhe zgjerimit të hapësirave të gjelbra, pyjeve dhe tokës bujqësore. Kujdes i veçantë do t'i kushtohet mungesës së tokave ndërtimore në zonat industriale të qytetit, dhe shëndrrimit të tokave të kategorive të tjera në tokë ndërtimore me qëllim të zhvillimit të zonave industriale.
  - Miratimi i udhëzimeve të qarta dhe transparente mbi politikën e lejeve të ndërtimit.
  - Miratimi i një plani të zhvillimit rural që synon promovimin e një arkitekture dhe një peizazhi që valorizon kontekstin lokal historik, mjedisin dhe banimin e qëndrueshëm.
  - Në Lagjen Skënderbeu do të investohen me qëllim të të rregullimit të lagjes dhe pershtatjes së saj me lagjet përreth.
  - Rregullimi i varrezave të qytetit, veçanërisht shtigjeve për vizita si ato kryesore dhe atyre dytësore, rregullimi i çeshmeve dhe vendeve për ndeje të familjeve gjatë vizitave dhe varrimeve. Sallë pritjeje dhe konak për ngushëllime për familjet që jetojnë nëpër banesa apo që nuk kanë kushte nëpër shtëpitë e tyre. Planifikimi dhe ndërtimi i parkingut te varrezat muslimane.

## Mobiliteti

Vlerësojmë se promovimi i një mobiliteti bashkëkohor dhe të qëndrueshëm është domosdoshmëri, ku ndarja e hapësirës publike është e ekuilibruar midis këmbësorëve, çiklistëve dhe automjeteve. Ne i kushtojmë rëndësi të veçantë mobilitetit, si mjet thelbësor i zhvillimit lokal, me pasoja direkte në aktivitetin ekonomik, krijimin e hapësirave të jetesës së përbashkët për të gjithë përdoruesit dhe përmirësimin e gasjes në objekte tregtare.

Sa i përket infrastrukturës rrugore, projektet tona prioritate janë si në vijim:

- Kumanovë, Rrugët Bajram Shabani, Vasil Glavinov, Trajko Jovanovski, Nikolla Vapcarov, Karadacki Ordedi Josko Ilievski, Veselin Gujevski, Jovan Popoviq, Esperanto, Tode Mendol, Jakup Asipi: urbanizimi cilësor i rrugëve por jo vetëm me asfaltim (sipas standardeve afatgjate) dhe asfaltimi dhe meremetimi i të gjitha rrugëve brenda komunës. Me qëllim të rregullimit të kaosit në komunikacion si mungesë e vendqëndrimeve për taksitë, do të bëhet caktimi i vendqëndrimeve për taksitë në shumicën e rrugëve të rëndësishme në qytet. Do të bëhet hapja dhe asfaltimi i rrugës Nënë Tereza nga udhëkryqi i rrugëve Veselin Gujevski me rrugën Jovan Popoviq deri në kyçjen në Seravë. Do të bëhet vazhdimi i rrugës Karadacki Ordedi nga udhëkryqi me rrugën Veselin Gujevski deri në daljen në Seravë sipas planit ekzistues. Do të asfaltohet i pjesa e rrugës Veselin Gujevski nga udhëkryqi me rrugën Karadacki Ordedi deri në daljen në rrugën Esperanto. Do të bëhet asfaltimi i pjesës së rrugës Tode Mendol nga ura e Rrahmanlisë deri në rrugën Jakup Asipi si dhe asfaltimi i rrugës Jakup Asipi.
- Kumanovë: vazhdimi i bulevardit “Oktomvriska Revolucija” prej te udhëkryqi afër stacionit të autobusëve, që shkon drejt vendbanimit me shumicë shqiptare Dardania dhe që përfundon me lidhje në autostradë dhe përfundon në rrugën rajonale Kumanovë-Llopat afër pompës së benzinës Alija Petrol. Do të realizohet projekti ekzistues për rrethrotullimin në udhëkryqin e bulevardit Oktomvriska Revolucija dhe Done Bozhinov. Do të rregullohen dy rrethrotullim në Bulevardin 3 MUB prej hyrjes në qytet deri në qendër të qytetit që janë zgjidhje e vetme që të zhbllkohet kaosi ne trafik që lidhë gati të gjithë rrugët kryesore të qytetit. Gjithashtu do të bëhet gjelbërimi dhe ndriçimi me panele solare të këtij bulevardi.
- Kumanovë, Lagja e Trimave, Lagja e Barakave dhe Lagja Bajram Shabani: urbanizimi cilësor i rrugëve por jo vetëm me asfaltim (sipas standardeve afatgjate). Kyçja e Lagjes së Trimave në autostradë si dhe ndërtimi i një mbikalimi i cili do ta lidh Lagjen e Trimave me rrugën për në fshatin

Rrahmanli. Me qëllim të shkarkimit të ngarkesës së komunikacionit te tregu i gjelbër, do të bëhet projektimi i një vendrrrotullimi në udhëkryqin e rrugëve Tode Mendol dhe 3MUB. Do të bëhet ndryshimi urgjent i regjimit të komunikacionit në shumicën e rrugëve të Lagjes së Trimave, më saktësisht futja e komunikacionit dy kahësh në rrugën Tode Mendol dhe Strashko Simonov, dhe mundësia e rrugëve tjera të kyçen me Bulevardin 3 MUB.

- Kumanovë: trasimi dhe asfaltimi i rrugës Petar Drapshin (“Govedarski pat”). Asfaltimi i pjesës së mbetur të rrugës Franz Rozman dhe Mladen Stojanovic. Rehabilitimi i rrugës Bllago Iliev Gune dhe Doktor Ribar, rrugës Hristian Todorovski Karposh, Kiro Fetak, etj si dhe zgjidhjen e problemit me ujërat atmosferik në Doktor Ribar.
- Kumanovë, Lagja Kosturnik: urbanizimi cilësor i rrugëve por jo vetëm me asfaltim (sipas standardeve afatgjate)
- Çerkez, Rramanli dhe Llopat: urbanizimi cilësor i rrugëve por jo vetëm me asfaltim (sipas standardeve afatgjate).

Propozimet tona tjera janë:

- Lidhja urgjente e vendbanimeve shqiptare me transport publik me linja të rregullta drejt qendrës së qytetit nga vendbanimet e Lagjes së Trimave, Bajram Shabanit dhe nga Rramanlia.
- Regjistri i rrjetit rrugor komunal dhe rajonal.
- Krijimi i një regjistri të vendeve me shkallë të lartë të aksidenteve të trafikut.
- Krijimi i zonave pedonale në qendër të qytetit.
- Identifikimi i rregullt i trotuareve të dëmtuara dhe intervenimi i shpejtë për të sanuar gjendjen.
- Miratimi i planit të çiklizmit, përfshirë zgjerimin e shtigjeve të biçikletave, subvencionimin e blerjes së tyre dhe bashkëpunimin me shoqatat e çiklistëve.
- Zbatimi i sistemit të kartelës së banorit në qendër të qytetit që siguron parkim falas për dy vetura për ekonomi familjare brenda lagjes.
- Vende të rezervuara parkimi dhe karrikimi për veturat elektrike.
- Krijimi dhe subvencionimi i vend parkingjeve nëpërmjet platformës digjitale.

- Ndërtimi i parkingjeve me pagesë, përmes koncesioneve të hapësirës publike për sektorin privat.

## Banimi i qëndrueshëm dhe i përballueshëm

---

Shtrengimi i rregulloreve të planifikimit urban dhe mungesa e ofertës së banimit të vogël dhe të mesëm, çon pashmangshëm në rritje të çmimeve të patundshmërisë dhe sjell pasoja tjera për mënyrën e jetesës dhe mobilitetin. Ne propozojmë:

- Promovimi i krijimit të njësive të reja banesore të adaptuara me sociologjinë e komunës, në bashkëpunim me autoritetet tjera publike dhe sektorin privat.
- Promovimi i projekteve mikste të ndërtimit në kuadër të zhvillimit urban. Objektet e reja duhet të kombinojnë funksionet e banimit, tregtisë, zyrave, kulturës, duke marrë gjithashtu parasysh mobilitetin (vendet e parkimit) dhe çështjet mjedisore.
- Krijimi i agjencisë së patundshmërisë sociale, duke inkurajuar pronarët t'i besojnë komunës administrimin e pronës së tyre.
- Lehtësimi i blerjes së shtëpisë apo banesës së parë për çiftet e reja, duke i stimuluar kompanitë që t'u shesin atyre me çmime pa profit dhe duke i liruar çiftet e reja nga pagesa e tatimit në pronë për aq kohë sa ata paguajnë këste të kthimit të kredisë banesore pranë një institucioni financiar.

VOTO

6

[paster.mk](http://paster.mk)

**PASTER.**